



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.32 Prot.

Tiranë, më 09.01.2024

### V E N D I M

#### Nr.5 , Datë 09.01. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën me nr. 97, datë 25.05.2023, paraqitur nga z. K.M kundër Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci”<sup>3</sup>, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të “racës”, “ngjyrës” dhe “për shkak se ka qenë i dënuar”.

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesi parashtron :

*“Unë jam K.M, i ati i B., për të cilën po ju drejtohem ju si institucion. Unë pas mosmarrëveshjeve me ish bashkëshorten time jemi ndarë dhe ish bashkëshortja ka marrë djalën me vete ndërsa vajzën e ka lënë tek mamaja ime, pasi fatkeqsisht unë në atë kohë u dënova dhe vuajta dënimin për 6 vite. Gjatë kohës që isha në burg komunikoja rregullisht me fëmijët derisa në një moment mamaja ime u sëmur dhe nuk e mbante dot më vajzën, e cila ishte rreth 4 vjeçe, ish bashkëshortja nuk e merrte dot dhe si përfundim mamaja ime e dorëzon fëmijën tek Bashkia Lezhë. Në sektorin përkatës, mamaja ime ka firmosur duke ia kaluar kujdestarinë e fëmijës dikujt tjetër pa ditur mirë se çfarë po firmoste pasi ideja ishte që fëmija të shkonte në jetimore shtetërore deri në lirim tim nga burgu. Si përfundim vajza ime përfundon në një Kuvend Murgeshash, të cilët mbajnë fëmijë të braktisur apo në situatë rruge. Në fillim kam komunikuar me vajzën pasi tashmë është rritur dhe pse unë nuk isha dakort që ajo të dërgohej në një institucion fetar, ku mund të ndikohet nga feja e tij. Unë dëshiroja që ajo të shkonte në një institucion jo fetar.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa është identifikuar fillimisht me emërtimin: Kisha Marie Tuci (Murgeshat që kujdesen për fëmijët në situatë rruge). Në vijim të procedurës është saktësuar emërtimi zyrtar i subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa është: Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci”.

*Murgeshat, duke parë reagimin tim të pakënaqur për faktin që vajza ime është aty, i bëjnë presion fëmijës deri në atë pikë sa fëmija im sipas tyre, thotë nuk dua ta takoj babin. Në takimet e mëparshme, shihet qartë se si ajo vjen me vrap tek unë. Tani nuk më lejojnë më as të flas në telefon me vajzën time. Unë si prind kam të drejtë ta takoj pavarësisht rrethanave që çuan që vajza ime të përfundonte aty. Unë nuk dua të braktisë vajzën time, thjesht dua që ajo të mbahet në një institucion shtetëror dhe jo fetar, pasi për momentin unë nuk e përfitoj dot kujdestarinë e vajzës sepse nuk kam një punë stabël këtu, pasi unë punoj herë pas here jashtë vendit dhe nuk kam një shtëpi këtu. Ish bashkëshortja për fat të keq gjithashtu ndodhet në burg, për këtë arsye ne kërkojmë që fëmija momentalisht të kalojë në një institucion shtetëror, deri në momentin që dhe ish bashkëshortja ime të dali nga burgu dhe të ribashkohemi si familje.*

*Unë diskriminohem nga Murgeshat për shkak të së shkuarës time, pra që kam qenë i dënuar dhe ato e dinë, si dhe për shkak të ngjyrës dhe racës, pasi unë i përkas komunitetit egjiptian. Theksoj se unë asnjëherë nuk i kam shkëputur lidhjet me fëmijët e mi, as kur kam qenë në burg. Pse duhet të më ndalohej të komunikoj apo të takoj fëmijën tim nga një qendër që nuk është as institucion shtetëror. Problematika ime nuk merret parasysh nga asnjë institucion ku jam drejtuar sepse më diskriminojnë për shkak të racës, ngjyrës time të lëkurës si dhe të shkuarës time.*

*Diskriminimi ka filluar në momentin që unë kam dal nga burgu dhe pasi kam takuar vajzën iu kam shprehur atyre që e shoqëronin që vajza duhet të kalojë në një institucion shtetëror, pastaj ato filluan diskriminimin duke më konsideruar një ish të dënuar dhe që i përkas një komuniteti që për ato nuk është i aftë të edukojë fëmijën. Nga ana tjetër, ato po më kthejnë vajzën kundër, duke i bërë presion dhe duke i ulur figurën time si prind. Ata pretendojnë që vajza nuk do vetë të më takojë, por kjo nuk është e vërtetë, pasi sa herë e kam takuar vajza është e lumturuar, po ashtu dhe kur familjarët e mi e kanë takuar ka qenë shumë e lumtur.*

*Rasti më i fundit që kam tentuar të komunikoj ka qenë data 22.05.2023, dhe më datë 24.05.2023 jam telefonuar nga NJMF në Bashkinë Lezhë (pas ndërhyrjes së Zyrës Rajonale Shkodër të KMD) që do flasin ato paraprakisht me vajzën, pasi vajza thotë që nuk do të më takojë. Rreth datës 6 mars jam kthyer nga Gjermania dhe deri në atë moment kam pas komunikim të rregullt me vajzën, në momentin që kthehem fillon diskriminimi sepse unë nuk isha dakort që vajza të rrinte aty.”*

Ankuesi kërkon nga Komisioneri që të marri masa që vajza e tij të kalojë në një institucion shtetëror si dhe ta takojë dhe komunikojë me vajzën rregullisht.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjerës Matara, është Person Juridik Kishtar, i Kishës Katolike në Shqipëri, i cili është regjistruar si organizatë jofitimprurëse me vendimin nr.2404, datë 24.03.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjerës Matara, është i pajisur me licencë Nr.LN-1393-04-2010, lëshuar në datë 22.04.2010, nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), për kryerjen e veprimtarisë: *“Shërbime të përkujdesit rezidencial (Shtëpi familje për personat në nevojë: minorenë dhe persona me aftësi të kufizuar)”*.

Sa më sipër rezulton se, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjerës Matara, në cilësinë e një personi juridik privat që ofron një shërbim publik dhe konkretisht shërbime të kujdesit shoqëror, në referim të nenit 7, të LMD, hyn në fushën e veprimit të LMD.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.684/1 prot., datë 13.06.2023, Komisioneri njoftoi dhe kërkoi informacion nga subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa në lidhje me pretendimet e paraqitura nga

ankuesi. Nëpërmjet kësaj shkrese, Komisioneri iu drejtua për informacion edhe Bashkisë Lezhë, si institucioni në juridiksionin e të cilit është e vajza e mitur e ankuesit e cila është sistemuar pranë subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion, ka kthyer përgjigje Instituti “Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara” Rezidenca “Marie Tuci”, duke parashtruar si vijon:

Asnjë nga pretendimet e ankuesit nuk qëndron. B. M (vajza e ankuesit) është pjesë e qendrës së tyre ku jeton e qetë dhe janë munduar që figura e babait të jetë pjesë e saj, por ka qenë shtetasi K.M që nuk është treguar korrekt, duke respektuar oraret dhe ditët e takimeve.

Në lidhje me historinë e B. M, subjekti sqaron se:

Janë thirrur në disa seanca gjyqi, ku kanë marrë pjesë motër M.D (M.N, pjesë e stafit të Rezidencës në atë kohë) dhe Madre M (C.E. R.S, eprore e Rezidencës dhe personit juridik Institutit “Shërbëtorët e Hyjit dhe të Virgjërës Matara” në Shqipëri). Në gjyq kanë qenë të pranishme të dyja murgeshat, punonjësja sociale, gjyshja e vajzës dhe babai i vajzës, i sjellë nga policia (gjatë kohës që ai ishte në burg). Gjyshja u prezantua dhe thoshte se ishte e sëmurë dhe e paaftë për t’u kujdesur më shumë për vajzën.

Rezidenca ka si objektiv kryesor edukimin gjithpërfshirës të vajzave, përfshirë shkollimin, akomodimin, ushqimin, veshjen etj. Të dy të afërmit (gjyshja dhe babai) i’u përgjigjën pozitivisht propozimit për ta dërguar vajzën në Rezidencë, pa vendosur ndonjë kusht.

B. është marrë në furgonin e Rezidencës bashkë me asistenten dhe gjyshen e vajzës. Gjyshja vinte për t’u vizituar herë pas here deri sa ajo nisej për në Itali (pa i thënë gjë vajzës). Vajza komunikonte me gjyshen në *WhatsApp*, ndërsa me të atin më rrallë me *Skype*, nga burgu. Vajza tregonte gjithmonë shumë për zemërsi ndaj gjyshes, indiferencë ndaj babait dhe refuzim ndaj nënës së saj, pasi i kishin thënë shumë gjëra të tmerrshme për të, si gjyshja ashtu edhe babai i saj, se ajo donte t’u vriste disa herë, duke e hedhur në lumë, se kishte dashur t’ia hidhte një makine që ta shtypte, se ajo nuk e ushqente, se e kishte goditur disa here në mur kur ishte foshnjë dhe se ajo ishte fajtoare e dënimit të babait të saj.

Kur babai i B. doli nga burgu, shkoi për të vizituar vajzën në Rezidencë, megjithëse vajza nuk tregoi interes për vizitën, ajo e priti pa pengesa. Në një rast, ai i la një letër vajzës të shkruar nga nëna e vajzës, drejtuar atij, ku e akuzonte atë, se, për shkak të tijin ajo ishte dënuar dhe për figurën e keqe që i kishin bërë para vajzës.

Marrëdhënia baba-bijë dhe me murgeshat ishte krejt normale. Por, në korrik 2021, ndodhi një ngjarje që ndryshoi të gjitha rrethanat, duke bërë që vajza dhe murgeshat të kenë frikë nga K.M, për sjelljen e tij të dhunshme. Konkretisht, duke qenë me pushime, në një shtëpi tjetër të Institutit, me kërkesën e asistentes sociale, janë pritur disa fëmijë për një natë dhe më pas erdhën t’i kërkonin për t’i kthyer te familja, pasi kishin mundur të qetësonin situatën. Nisur nga

kjo, B kishte iluzionin se edhe ajo do të kishte një familje me të cilën do të dilte herë pas here dhe këtë ia ka shprehur punonjësës sociale që shoqëronte fëmijët. Për këtë arsye, punonjësja sociale sugjeroi që të shkonte për një fundjavë me të atin, gjë që ajo pranoi me kënaqësi.

U organizua një ditë që babai të shkonte të merrte vajzën. Një ditë më parë vajza mori një telefonatë nga babai i saj për të koordinuar orarin për t'a marrë. Ndërsa Madre M. ishte pranë vajzës kur mori telefonatën, vajza i kërkoi orarin për të shkuar së bashku me të atin, por motra i'a bëri të qartë se, nuk mund të shkonte dhe motra me të, se ishte një fundjavë ku ajo do të shkonte vetëm me të atin. Atëherë vajza reagoi shumë keq, duke thënë se nuk e kishte kuptuar se ishte kështu, se do të shkonte vetëm ajo, e pashoqëruar nga një motër, dhe i lutej motrës që t'a shoqëronte. Motra i thoshte që duhet të koordinonte orarin sikurse i vlente babait të saj. Të nesërmen do të takoheshin në mëngjes, në atë banesë të përkohshme. Kur morën telefonatën nga babai se ishte afër, dolën në udhëkryq për t'i treguar rrugën, pasi ai nuk e njihte shtëpinë. Vajza ishte për dore me Madre M. dhe Motër Sh. (M. Sh, një misionare në Greqi). Kjo e fundit ka lëshuar një deklaratë në lidhje me ngjarjen. Një tjetër person i cili ka lëshuar gjithashtu një deklaratë në lidhje me ngjarjen, është shtetasi E.K", i cili, kishte mbërritur në momentet e ngjarjes, bashkë me misionarë italianë, të cilët donin të ndërhynin, por është preferuar që ata të mos ndërhynin në këtë çështje dhe kështu ata vazhduan rrugën.

Subjekti informon gjithashtu se, përveç ngjarjeve të mësipërme, në shumë raste kanë marrë fyerje dhe kërcënime të dhunshme përmes telefonit nga z. M. Pas gjithë kësaj, ata shprehen se, frika e tyre ndaj z. K.M dhe synimi i tyre për t'u mbrojtur nuk është i egzagjeruar. Në këtë, ngjyra, raca, origjina, historia apo feja nuk kanë asnjë lidhje, duke qënë se vajza e tij, të mirën e së cilës ata kanë kërkuar në çdo kohë ka të njëjtën ngjyrë, racë dhe fe. Para këtyre ngjarjeve z. K.M, ka mundur të komunikojë pa problem me vajzën dhe me murgeshat edhe pse arsyet për të cilat i akuzon ishin të njëjtat.

- Në përgjigje të kërkesë për informacion, ka kthyer përgjigje edhe Bashkia Lezhë me shkresën nr.7050/1 prot., datë 27.06.2023, duke vendosur në dispozicion një relacion shpjegues që mban datën 23.06.2023, të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), ku ndër të tjera informon se:

E mitura B.M, e bija e K.M dhe V.J, është një rast i menaxhuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve që nga viti 2017. B. është braktisur nga nëna biologjike në moshën 8 muajshe dhe si rrjedhojë e kësaj për B. është kujdesur gjyshja, M.U, pasi babai i saj K.M vuante dënimin me heqje lirie në Reç, Shkodër. M. është kujdesur pa një vendim gjykate dhe NJMF, pasi i është referuar rasti ka mbështetur familjen me pako ushqimore, veshmbathje për fëmijën si dhe i është ofruar asistencë ligjore falas, duke e orientuar drejt procedurave ligjore për marrjen e kujdestarisë së mbesës.

M. është kujdesur për B. për 3 vite rresht. Gjatë gjithë kësaj kohe ka patur mbështetje për rritjen dhe mirëedukimin nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkizë Lezhë. Pas kësaj periudhe kohe, M. ka kërkuar heqjen e kujdestarisë ligjore për shkak të pamundësisë së saj

fizike dhe shëndetësore për t'u kujdesur për të. Ajo ka kërkuar dërgimin e të miturës në një institucion të kujdesit social "E Lumja Marie Tuci" Troshan, institucion që akomodon vajza nga mosha 0-18 vjeç. Arsyeja e kërkesës së saj për ta dërguar në këtë institucion ka qenë fakti që është lehtë i aksesueshëm për shkak të distancës në kilometra dhe se në këtë institucion ka patur eksperiencë të mëparshme që kanë rezultuar pozitive. Kërkesa e znj. M.U ka marrë formë të prerë me datë 22.01.2020, duke u pranuar kërkesa e znj. U. dhe vendosja në kudestarti të fëmijës B.M pranë institucionit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca Marie Tuci. Gjatë kohës së qëndrimit në institucion, kanë ndjekur mbarëvajtjen e të miturës. B. ndjek arsimin fillor me rezultate shumë të mira në një shkollë pranë njësisë ku është akomoduar. Gjatë takimit të fundit që z. K.M ka zhvilluar me vajzën, ata si institucion kanë qenë prezent, pasi kishin kërkuar vetë që takimi të zhvillohej në zyrat e bashkisë. Vajza nuk ishte shumë entuziaste ndaj takimit me babain dhe shprehej se kishte frikë nga ai, se ai fliste fjalë të pista, shante motrat të cilat kujdeseshin shumë mirë për të.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *"8. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar."*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore. Nëpërmjet shkresës nr.648/4 prot datë 18.08.2023, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 28.08.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 28.08.2023, me pjesëmarrjen e Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, përfaqësuar nga Motër C. E. R.S dhe Bashkisë Lezhë, përfaqëuar nga znj. E.P, me detyrë specialist e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe znj.N. Sh, specialist e strehimit social, pranë Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social, sipas autorizimit me nr.13163/1 prot., datë 28.08.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të z. K.M, i cili nuk u paraqit dhe nuk paraqiti ndonjë arsye për mungesën. Referuar lajmërim marrjes së shërbimit postar (administruar në dosje), rezultoi se shkresa për datën dhe orën e seancës dëgjimore, i është dorëzuar nga shërbimi postar kumatës së tij, znj.Xh.M. Në referim të nenit 161 *"Njoftimi nëpërmjet të tretit"*, të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA)<sup>4</sup>, Komisioneri vlerëson se, njoftimi i ankuesit është kryer konform mënyrave dhe mjeteve të njoftimit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Gjatë seancës dëgjimore, palët pjesëmarrëse i qëndruan deklaratave të tyre në lidhje me situatën e të miturës B.M, ndërkohë në lidhje me pretendimin e ankuesit për refuzim apo pengesa për takim me vajzën, ato u shprehën se nuk ekzistojnë. Për shkak të incidentit është

---

<sup>4</sup> Neni 161, pika 1, germa "a", tw KPrA, parashikohet: *"1. Kur nuk është i mundur njoftimi, sipas nenit të mësipërm, dhe marrësi nuk gjendet, nëpunësi i organit publik bën dorëzimin nëpërmjet një të treti, që pranon t'ia dorëzojë njoftimin marrësit, sipas kësaj radhe preference: a) një personi të familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç, në vendin e njoftimit të parashikuar në nenin 151, pika 1, shkronja "a", e këtij Kodi;"*

marrë vendim nga strukturat e përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve, që ai mund të vijojë takimet por në mënyrë të mbikëqyrur dhe në prezencë të punonjësve sociale.

3. Në vijim të seancës dëgjimore, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, depozitoi pranë Komisionerit informacion dhe dokumentacion plotësues në lidhje me ankesën dhe situatën e të miturës B.M..
4. Me shkresën nr.648/6 prot datë 25.09.2023, Komisioneri iu drejtua Bashkisë Lezhë duke kërkuar vendosjen në dispozicion të Komisionerit informacionin dhe dokumentacionin në lidhje me trajtimin dhe ndjekjen e rastit të vajzës së mitur të ankuesit B.M, i cili nuk ishte depozitua nga Bashkia Lezhë sipas kërkesave dhe afateve të kërkuara.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme për informacion, me shkresën nr.14978/1 prot datë 03.10.2023, Bashkia Lezhë vendosi në dispozicion praktikën e ndjekur për menaxhimin e rastit të të miturës B.M që nga momenti i referimit pranë Njesisë së mbrojtjes së fëmijëve. Sipas relacionit me datë 02.10.2023, të hartuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, ndër të tjera relatohet se:

*“.....Gjatë kohës së qëndrimit në institucion kemi ndjekur mbarëvajtjen e të miturës. B. ndjek arsimin fillor me rezultate shumë të mira në një shkollë pranë njesisë ku është akomoduar. I ati i fëmijës z. K pasi ka kryer dënimin është paraqitur pranë zyrave tona, duke shprehur interes për marrjen e kujdestarisë së vajzës. Duke e konsideruar këtë hap shumë të rëndësishëm për bashkimin e vajzës me familjen biologjike menjëherë kemi ofruar mbështetje me bonus qiraje për të patur si fillim një vend të sigurt qëndrimi, gjithahstu e kemi orientuar drejt praktikave të mira në bashkëpunim me zyrën e punës për të siguruar një mundësi punësimi. Kjo mundësi është refuzuar nga z.K pasi ai ka pohuar që është i punësuar pranë një skuadre futbollit nga një miku i tij. Gjatë kësaj kohe i kemi ofruar ndihmë ligjore falas për ta ndihmuar në përgatitjen e dokumentave për marrjen e kujdestarisë por që asnjëherë nuk ka patur interes të bashkëpunojë. z.K nuk ka rezultuar asnjëherë gjatë gjithë kësaj periudhe i siguruar në ndonjë vend pune. Vlen të theksohet që interesi i z.K për takimet me të bijën nuk kanë qenë të vazhdueshme pasi ai me periudha të zgjatura 2-3 mujore humbiste çdo kontakt dhe sa herë kemi bërë vizitë në shtëpinë e tij qiranë e të cilës e ka mbuluar Bashkia Lezhë, ai nuk ka rezultuar prezent. Gjatë periudhës së pushimeve verore fëmijët e qëndër transferohen në një qëndër tjetër që është linjë e qëndrës “E lumja Marie Tuci” në Arramenas. Në këtë kohë ka ndodhur një incident me të atin e fëmijës dhe motrat që shërbejnë pranë kësaj qëndre. Ndryshe nga të gjitha herët e tjera që z.K. ka zhvilluar takime me vajzën, ky moment nuk ka rezultuar aspak pozitiv dhe frytëdhënës, pasi ngjarja dhe diskutimet kanë degraduar deri në dhunë fizike, e pohuar kjo nga motrat dhe dëshmitë e të pranishmëve. Nga ky moment z. K. nuk është takuar me të bijën për dy muaj dhe gjatë kësaj kohe ka denoncuar rastin në emisionin STOP duke pretenduar që janë shkelur të drejtat dhe nuk është takuar me të bijën. Z. K. ka vazhduar kontaktin me anë të telefonit pasi përsëri është larguar jashtë vendit. Gjatë kësaj kohe vajza ka marrë këshillim në qëndër. Pasi z. K. është kthyer ka tentuar të takojë të bijën, gjë e cila është*

*bërë e mundur nga punonjëset sociale të shërbimit social. Aktualisht qendra është kujdestare ligjore dhe e mitura ka kujdestar ligjor motër C.E. R. S”.*

5. Me shkresën nr.648/8 prot datë 17.10.2023, Komisioneri, i komunikoi ankuesit aktet shtesë, të vendosura në dispozicion nga Bashkia Lezhë dhe Institutit “Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara”.

#### **I. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, ankuesi K.M, është i datëlindjes 10.04.1987, lindur dhe banues në Lezhë. Ankuesi është babai i një vaje të mitur, të quajtur B.M, e datëlindjes 01.09.2014, e cila ka lindur nga marrëdhënia e ankuesit K.M me shtetasen V.J, me të cilën ankuesi nuk ka patur një martesë ligjore.

Referuar raporteve të vlerësimit psiko-social dhe vendimeve gjyqësore, rezulton se, fëmija B.M, nga lindja dhe deri në moshën 3 vjeçare është rritur nga gjyshja e saj nga babai znj. M. U (nëna e ankuesit). Kjo e fundit në me vendimin nr.357, datë 08.06.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është caktuar si kujdestare e të miturës B.M. Në bazë të vendimit nr.04, datë 22.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, fëmija B.M është vendosur në kujdestari pranë Institucionit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca Marie Tuci. Referuar vendimit të gjykatës, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara i ka deleguar motër C.E.R.S të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit. Në këtë vendim, Gjykata ka urdhëruar Shërbimin Social të Bashkisë Lezhë dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Lezhë që një herë në muaj, ditën e hënë të javës së tretë, të kontrollojnë progresin e edukimit dhe arsimit të fëmijës duke përgatitur dhe raportet përkatëse për ecurinë e progresit edukativ.

Fëmija B. M është akomoduar pranë Rezidencës Marie Tuci, të Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, ku edhe vazhdon të qëndrojë, që prej datës 23.01.2020, fakt ky që rezulton sipas procesverbalit të mbajtur midis specialistit të NJMF në Bashkinë Lezhë dhe përfaqësuesit të Rezidencës Marie Tuci. Referuar këtij procesverbali, referimi dhe dorëzimi i fëmijës B.M, në shërbimin e emergjencës pranë Rezidencës Marie Tuci, është bërë me arsen se : *“Dyshohet se fëmija është i neglizhuar dhe jeton në rrethana që vendosin në rrezik jetën dhe shëndetin e fëmijës”.*

Në bazë të vendimit të nr.04, datë 22.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vajza e ankuesit, B.M, ka si kujdestar ligjor Institutin Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara.

Rezulton se, në datën 24.09.2015, ankuesi K.M, është ndaluar nga strukturat e policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit”, vepra penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 114, të Kodit Penal. Rezulton se ankuesi është dënuar me



burgim me vendimin nr.136, datë 18.11.2016, të Gjykatës për krimet e rënda Tiranë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, më datë 28.12.2016. Nuk u administrua informacion i saktë në lidhje me vitet e dënimit me burgim të vuajtura nga ankuesi, por referuar akteve të administruara rezulton se, gjatë shqyrtimit gjyqësor për heqjen e kujdestarisë nga znj. M.U dhe vendosjen në kujdestari të fëmijës B.M, pranë Institutit, të përfunduar me vendimarrjen e gjykatës në datën 22.01.2020, ankuesi K.M ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Shenkoll Lezhë. Ndërkohë, bazuar në deklaratimet e Institutit, Bashkisë Lezhë dhe shtetasve E.K dhe M.Sh, në lidhje me ngjarjen ku pretendohet se ankuesi ka tentuar të marrë me forcë vajzën e tij B.M, ngjarje e cila deklarohet të ketë ndodhur në datën 10.07.2021, ankuesi rezulton të ketë dalë nga institucioni i vuajtjes së dënimit.

Bazuar në deklaratimet e palëve në proces, konfirmohet se, ankuesi gjatë kohës që ka qenë duke vuajtur dënimin penal me burgim, ka mbajtur kontakte me vajzën e tij nëpërmjet telefonit.

Ankuesi pretendon se diskriminimi ndaj tij ka filluar në momentin që ai ka dalë nga burgu (ankuesi nuk jep një datë të saktë se kur ka ndodhur ky fak), pasi ai iu ka shprehur personave që shoqëronin vajzën se ai nuk dëshironte që vajza e tij të kalonte në një institucion shtetëror. Ankuesi pretendon se, në këtë moment ai është diskriminuar, duke e konsideruar të paaftë për të edukuar vajzën e tij për shkak se kishte qenë i dënuar dhe i përkiste komunitetit egjiptian. Ankuesi pretendon se, vajzës i bëhet presion që të mos e takojë atë duke ulur figurën e tij si prind dhe nuk i është lejuar që të komunikojë as nëpërmjet telefonit dhe as të takohet me vajzën. Ankuesi deklaron se është kthyer në datën 6 mars 2023 nga Gjermania dhe deri në këtë moment ka patur komunikim të rregullt me vajzën. Pas këtij momenti fillon diskriminimi sepse nuk ishte dakort që vajza të qëndronte pranë Rezidencës Marie Tuci. Ankuesi pretendon se, dy rastet e fundit kur ka tentuar të komunikojë me vajzën ka qenë në datat 22.05.2023 dhe pas këtij momenti, në datën 24.05.2023 është telefonuar nga NJMF në Bashkinë Lezhë, se do të ishin këto të fundit që do të komunikonin me vajzën, nëse ajo pranonte ta takonte ankuesin.

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar nga ana e Institutit “Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara”, Rezidenca Marie Tuci për shkak të racës, ngjyrës dhe statusit të tij si ish i dënuar, duke mos e lejuar që të komunikojë dhe të takohet me vajzën e tij të mitur B.M.

Deklarimet e ankuesit në lidhje me momentin kur ai pretendon se është diskriminuar duke iu mohuar kontaktet dhe takimet me vajzën janë ta paqarta. Njëherë ankuesi deklaron se diskriminimi ka filluar pasi ka dalë nga burgu, ndërsa një moment tjetër deklaron se është diskriminuar dhe kontakti me vajzën i është mohuar pasi është kthyer nga Gjermania, rreth datës 6 mars 2023 dhe se, para këtij momenti ka patur komunikim të rregullt me vajzën.

Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, prapësuan si të pabazuar pretendimet e ankuesit. Ata parashtruan se, ankuesi ka patur vizita të rregullta me vajzën pas daljes nga burgu dhe se marrëdhëniet babë-bijë dhe me murgeshat kanë qenë normale. Instituti deklaron

se, rrethanat ndryshuan pas një ngjarje të ndodhur në datën 10.07.2021, ngjarje që sipas tyre frikësoi vajzën dhe murgeshat duke bërë që ato të kenë frikë nga ankuesi, për shkak të sjelljes së tij të dhunshme.

Në lidhje me ngjarjen e datës 10.07.2021, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, parashtroi se, në këtë datë ishte organizuar një ditë që babai të shkonte të merrte vajzën për të qëndruar së bashku në fundjavë. Ditën e takimit vajza ishte në shoqërinë e Motër M. dhe Motër Sh., duke pritur ankuesin që të vinte për të marrë B.. Sipas tyre, vajza nuk ka dashur të largohet vetëm me babain dhe se ky i fundit ka tentuar ta fusi me forcë në makinë, duke përdorur një fjalor të papërshtatshëm, e duke shfaqur një sjellje të dhunshme. Nga një telefonatë me punonjësen sociale, kjo e fundit u ka komunikuar se, babai nuk mund ta marrë vajzën nëse ajo nuk dëshiron. Për ngjarjen ka mbërritur policia, e cila ka shoqëruar ankuesin në Komisaratin e Fushë Krujës. Me qëllim që K. të mos ndëshkohej pasi sapo kishte dalë nga burgu, subjekti deklaroi se nuk paraqitën zyrtarisht denoncim kundrejt tij në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 10.07.2021.

Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, nga ana e Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, u depozituan në cilësi prove dy deklarata noteriale, lëshuar nga shtetasit M.Sh dhe E.K.

Konkretisht, sipas Deklaratës Noteriale me nr. 4135 rep., nr.2622 kol, datë 31.08.2023, hartuar para Noterit Vasil Martini, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër, shtetasja M.Sh, ka deklaruar se:

*“Më datë 10.07.2021 në fshatin Arrameras, sapo hyra në shtëpi, përgjegjësjë e Qendrës Marie Turci C. E. R. S (Madre M.) më kërkoi që ta shoqërojë sepse do të vinte babai i B. të marrë fëmijën. Por që në momentin kur femija (B.) kuptoi që do të shkonte vetëm me të atin, nuk donte të shkonte. Por donte thjesht ta përshëndeste dhe te qëndronte me motrat... Dolëm nga shtëpia për tu takuar me babain e B.... Kur po afrohem përball portës së manastirit të motrave tona të Shën Jozefit, K. zbriti nga makina dhe po vinte drejt nesh. Më përshëndeti mua meqënëse jemi nga i njëjti qytet dhe njëjta familjen time... Dhe në fund më tha se kishte ardhur për të marrë vajzën për ta çuar në një kënd lojrash. Dhe në atë moment B. filloi të qante sepse nuk donte të shkonte me të dhe ai fillonte ti thoshte: Pse nuk do te vish me mua unë jam babai yt, kam ardhur të marrë dhe çoj tek këndi i lojrave të blejë cokollata etj. Por vajza insistonte se nuk donte të shkonte me të dhe mbante të shtrënguar dorën e madre M. dhe ai filloi ti bërtiste motrës ta lëshonte vajzën por vajza edhe më fortë shtrëngonte dorën e motrës ai filloi të bërtiste dhe ti thoshte motrës lëshoje vajzën çfare i keni bërë vajzës time dhe përdorte fjalë jo të përshtatshme... Situata vazhdoi dhe u bë me intesive. (Personi i dytë që shoqëronte K. erdhi drejt nesh por thjesht për të përshëndetur në momentin kur situata u bë acaruese ai tha se thjesht kishte ardhur sepse K. i kishte kërkuar të shoqëronte dhe që nuk donte të përzihej në këtë çështje. Dhe me dha çelësin e makinës.) Në atë moment arritën nga Shkodra një grup seminaristash të rinjë që studiojnë për tu shuguruar meshtarë) që ishin të shoqëruar ng Zoti E.K*

*(vullnetarë dhe bamirës i motrave tona) i cili u ndalua dhe erdhi drejt nesh për të na ndihmuar. Ndërkohë që po arrinin personat e sipër përmendur, K. kapi vajzën me forcë dhe e futi në makinë, thërriste shoferin e makinës, që të ndizte makinën që të iknin, duke përdorur në prani të fëmijës fjalë shumë të ndyra dhe duke kërcënuar shoferin që të ndizte makinën përndryshe do ta vriste. Madre M. në atë moment ma dha telefonin e saj që të flisja me asistenten sociale me Anën që ta informoja se çfarë po ndodh. Ana më tha se ai nuk mund ta marrë vajzën nëse vajza nuk do. Në atë moment dolën jashtë nga makina dhe vajza tërhoqte madre M. drejt shthtëpisë, ai bërtiste duke thënë fjalë të ndryshme të pista ndaj nesh duke filmuar personat që përmenda më sipër, që sapo kishin arritur dhe duke thënë se do na çojë tek FIKSI. Ndërkohë arriti patrulla e policisë e përbërë nga dy punonjës, të cilët u drejuan drejt meje më pyetën se çfarë problemi kishim dhe morën K.n në Komisariatit e Fushë-Krujës. Pas gjysëm ore shkuam dhe tërhoqëm denoncimin për arsye se nuk donim që K. të ndëshkohej për këtë veprim.”*

Ndërkohë referuar Deklaratës Noteriale nr.3037 rep., nr. 1145 kol., datë 26.08.2023, hartuar para noterit Vasil Martini, anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Shkodër, shtetasi E.K, ka deklaruar se:

*“Më datën 10.07.2021 në fshatin Arrameras, pranë Manastirit Shën Jozef kam qenë duke u kthyer bashkë me persona të tjerë në makinën e Priftërinjëve që kishin ardhur nga Italia me mision pranë Kishës që ndodhet aty. Kam parë në rrugë dy Motra, dy persona meshkuj rreth moshës 40 vjeç dhe një fëmijë të vogël rreth 8 vjeç. Njëri nga personat meshkuj po tentonte të merrte me forcë vajzën e vogël nga duart e njerës Motër. Kam parkuar makinën dhe në këtë çast kam dëgjuar ulërime të vajzës së vogël dhe të një burri. Jam afruar me vrap e kam vënë re që njëri nga personat meshkuj kishte marrë vajzën e vogël e po tentonte ta fuste në një makinë me dhunë kundër dëshirës së të miturës e cila qante me dënesë. Në këtë çast është afruar njëra nga Motrat duke tentur të merrte vajzën që qante me dënesë dhe përmendte emrin e saj dhe kam parë që personi, i cili po mbante pa dëshirë vajzën e mitur ka goditur motrën me grusht. Në këtë çast kam ndërhyrë duke tentuar të neutralizoj zotërinë, i cili shante e ofendonte Motrat, e mbante me forcë vajzën e mitur, ka qenë lehtësisht e dukshme dëshira e të miturës për të qëndruar me Motrat e përballë kësaj situate jam përpjekur të qetësoj zotërinë dhe ta bind atë të lëshojë vajzën. Më vonë kam mësuar se ai zoteri ishte i ati i të miturës dhe se Motrat e kishin këtë fëmij nën kujdesin e tyre. Kam lajmëruar ndërkaq policinë në numrin 129 dhe një patrullë e përbërë nga dy punonjës të Policisë së Shtetit ka mbërritur aty në më pak se 10 minuta. I ati i vajzës është shoqëruar me furgonin e forcave të rendit ndërsa unë kam shkuar në Rajonin e Fushë- Krujës ku kam dhënë këtë deklaratë.*

Ngjarja e datës 10.07.2021 dhe sjellja e dhunshme e shfaqur nga ana e ankuesit, u konfirmua edhe nga përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë gjatë shqyrtimit të ankesës.

Gjatë procedurës së shqyrtimit të çështjes, ankuesit iu vendosën në dispozicion të gjitha parashtrimet dhe aktet e depozituara nga Instituti dhe Bashkia Lezhë, në lidhje me ngjarjen e datës 10.07.2021. Ankuesi në pretendimet e paraqitura në ankesë nuk jep asnjë informacion ose

qëndrim në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 10.07.2021 dhe gjatë shqyrtimit të ankesës nuk paraqiti asnjë kundërshtim në lidhje me parashtrimet dhe aktet e depozituara nga subjekti kundër të cilit ka paraqitur ankesën, për sa i përket kësaj ngjarje.

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga NJMF Bashkia Lezhë, rezulton se, nga ky moment ankuesi nuk është takuar me të bijën për dy muaj dhe gjatë kësaj kohe ai ka denoncuar rastin e tij në emisionin STOP, duke pretenduar se janë shkelur të drejtat e tij dhe nuk është takuar me të bijën.

Nga verifikimet e kryera nga ana e Komisionerit, u konstatua se, në emisionin STOP, që transmetohet në Tv Klan, në datën 14.12.2021<sup>5</sup>, është transmetuar një kronikë ku ankuesi denoncon rastin e tij duke pretenduar se nuk është lejuar që të takohet me vajzën e tij. Gjatë kronikës së transmetuar në këtë emision, rezulton se ankuesi ka realizuar një takim me vajzën e tij. Nga përmbajtja e kronikës së transmetuar në këtë emision, nuk rezulton e qartë se kur janë realizuar xhirimet e kronikës dhe kur është realizuar takimi midis ankuesit dhe vajzës së tij. Por, nga përmbajtja e procesverbalit të mbajtur në datën 22.10.2021 ora 12:00 në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, në Bashkinë Lezhë, rezulton se kronika e transmetuar në emisionin STOP të datës 14.12.2021, duhet të jetë xhiruar në datën e mbajtjes së procesverbalit ose gjatë muajit tetor 2021. Ndër të tjera, në këtë procesverbal pasqyrohet fakti se, situata e krijuar ka ndikuar negativisht tek fëmija B.M dhe se ajo në ato momente duhet të ndiqet nga psikologu i shoqatës ndërsa NJMF duhet ti drejtohet ASHDMF<sup>6</sup> për të mundësuar një psikolog të licensuar për të bërë një vlerësim psiko-social të vajzës. Në këtë procesverbal relatohet se: *“Duke qenë se i ati ka kërkuar ta marrë vajzën në fundjavë (dt.23.10.2021), ai thjesht do e takojë në qendër, por jo ta marrë pasi nuk është i besueshëm për ta marrë vajzën. Për shkak të gjendjes psikologjike të vajzës bazuar në takimin e fundit me vajzën prezent tek shoqata do të jenë edhe shërbimi social rajonal dhe punonjësja e policisë”*. Nga tërësia e akteve, parashtrimeve dhe deklarimeve të bëra nga palët nuk ka informacion nëse ankuesi është takuar me vajzën e tij në datën 23.10.2021. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë vlerësim psiko-social që i është bërë fëmijës B.M pas ngjarjes së ndodhur në datën 10.07.2021, as nga ana e Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara dhe as nga Bashkia Lezhë.

Pas këtij momenti ankuesi nuk ngre pretendime se nuk është lejuar të takohet me vajzën deri në momentin që ai deklaroi se është kthyer nga Gjermani, datë 06.03.2023. Në informacionin e vendosur në dispozicion nga NJMF Bashkia Lezhë, theksohet se, interesi i ankuesit për takimet me të bijën nuk kanë qenë të vazhdueshme, pasi ai me periudha të zgjatura 2-3 mujore humbiste çdo kontakt dhe herë që përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë kanë bërë vizitë në shtëpinë, qiranë e të cilës e ka mbuluar kjo bashki, ai nuk ka rezultuar prezent. Vetë ankuesi deklaroi se herë pas herë largohet jashtë vendit, pasi nuk ka një punë stabël.

Në parashtrimet e bëra në ankesë, ankuesi deklaroi se pasi është kthyer nga Gjermania në datën 06.03.2023, ka tentuar të takojë vajzën në datë 22.05.2023, por nuk është lejuar. Ai

<sup>5</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=mu3VqRnahNk>

<sup>6</sup> Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

pretendon se në datën 24.05.2023 është kontaktuar nga shërbimi social i Bashkisë Lezhë, për të mundësuar takimin me vajzën, nëse edhe vajza do të kishte dëshirë që të takohej me ankuesin.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga NJMF, Bashkia Lezhë, rezulton se, me kërkesën e ankuesit, midis tij dhe vajzës së tij janë realizuar dy takime, një në datën 12.07.2023 dhe tjetri në datën 01.09.2023. Takimi i datës 12.07.2023 është realizuar në zyrat e shërbimit social të Bashkisë Lezhë. Takimi i datës 01.09.2023, gjatë të cilit B. ka takuar edhe vëllain e saj, është realizuar tek parku i lojrave, afër Bashkizë Lezhë, pasi ankuesi kishte shprehur dëshirën që të drekonte së bashku me vajzën. Gjatë këtij takimi ishin prezent edhe xhaxhai i B. bashkë me familjen e tij. Sipas informacionit dhe akteve të vendosura në dispozicion nga NJMF Bashkia Lezhë, ankuesi edhe pse ka kërkuar të takohet me vajzën e tij dhe është dakortësuar midis shërbimeve sociale të Bashkisë Lezhë dhe kujdestarit ligjor të fëmijës B.M, Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, që takimet të realizoheshin në datën 06.06.2023 dhe në datë 11.07.2023, ankuesi nuk është paraqitur fare ose nuk është paraqitur në orarin e caktuar.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë deklaruan se, shërbimet sociale të kësaj bashkie, pas vlerësimit të situatës së krijuar, janë ata që kanë vendosur që takimet midis ankuesit dhe vajzës së tij Btë zhvillohen të mbikëqyrura nga ana e shërbimeve sociale. Edhe në informacionin me shkrim të përcjellë nga NJMF Bashkia Lezhë theksohet se, pasi ankuesi është kthyer nga jashtë shtetit, takimet midis ankuesit dhe vajzës së tij janë bërë të mundura nga punonjëset sociale të shërbimit social dhe janë mbikëqyrur nga këto të fundit.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është cenuar në të drejtën e tij si prind për të patur kontakte dhe për tu takuar me vajzën e tij B.M, Komisioneri ka marrë në shqyrtim faktet dhe rrethanat e konstatuara si më sipër gjatë shqyrtimit të ankesës, duke i analizuar dhe vlerësuar ato në raport me legjislacionin e mëposhtëm:

## **Kodi i Familjes**

### **Neni 2**

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

### **Neni 3**

Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

## **Neni 6**

Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohet, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse për shkaqe të rënda dhe me një vendim tepër të motivuar.

I mituri mund të dëgjohet vetë, nëpërmjet një avokati ose një personi të zgjedhur prej tij.

Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale.

## **Neni 215**

Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij

## **Neni 224**

### **Pamundësia e ushtrimit të përgjegjësive prindërore**

Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtarit të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes. Në këtë rast merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë.

## **Neni 263**

### **Vendosja e kujdestarisë**

Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, për shkak se të dy prindërit kanë vdekur ose nuk njihen, janë shpallur si të pagjetur, u është hequr përgjegjësia prindërore ose u është hequr zotësia për të vepruar, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata.

Gjykatë kompetente për vendosjen në kujdestari të të miturit është ajo e vendbanimit ose vendqëndrimit të të mitur

## **Neni 271**

### **Kujdestaria në Institucionet e Përkujdesjes**

Kujdestaria mbi të miturin, i cili nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të licencuar për përkujdesjen e fëmijëve.

Drejtuësi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit.

Drejtuësi i institucionit, brenda 10 ditëve nga caktimi i personit që merr funksionet e kujdestarit, i dërgon gjykatës aktin përkatës, i cili depozitohet në dosjen gjyqësore dhe pasqyrohet në regjistrin e kujdestarisë.

## **Neni 272**

### **Funksionet e Kujdestarit**

Kujdestari kujdeset për të miturin, e përfaqëson atë në të gjitha veprimet juridike dhe administron pasurinë e tij, sipas dispozitave të këtij Kodi.

## **Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**

### **Neni 5**

#### **Parime të përgjithshme**

Realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

.....

2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.

.....

4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t'i krijuar kushtet e jetesës, për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës

5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.

10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

### **Neni 6**

#### **Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës**

1. Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohet parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

a) nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në njëfamilje;

b) mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe ftësisë së tij për të kuptuar;

c) historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;

ç) aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;

d) vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore

## **Neni 9**

### **E drejta për të qëndruar me prindërit**

.....

3. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

4. Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

.....

6. Për qëllime të këtij ligji, marrëdhëniet personale mund të ndërtohen nëpërmjet:

a) takimeve ndërmjet fëmijës dhe prindit ose një personi tjetër, i cili, sipas ligjit, ka të drejtë të mbajë kontakte me fëmijën;

b) vizitave të fëmijës në mjedisin e banimit;

ç) korrespondencës ose çdo forme tjetër komunikimi me fëmijën;

d) dërgimit të informacionit fëmijës, lidhur me prindërit e tij ose personat e tjerë që, sipas ligjit, kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie personale me fëmijën;

dh) transmetimit, nga personi që jeton me fëmijën, të informacionit lidhur me të, duke përfshirë foto të fundit të tij, raporte mjekësore ose psikologjike tek i afërmi tjetër që ka të drejtë të mbajë marrëdhënie personale me fëmijën;

e) takimeve të fëmijës me të afërmit e tij ose me persona të tjerë, me të cilët fëmija është i lidhur

emocionalisht, në një mjedis neutral për fëmijën, me ose pa mbikëqyrje, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të



ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD..

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për të takuar dhe për të mbajtur marrëdhënie personale me vajzën e tij të mitur;
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- arsyeja për këtë trajtim të padrejtë dhe të pafavorshëm është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm, duke vlerësuar nëse ankuesit i është cenuar e drejta e tij si prind për të takuar dhe për të mbajtur marrëdhënie personale me vajzën e tij të mitur B.M.

Sikurse rezulton e provuar, me vendimin nr.04, datë 22.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vajza e ankuesit B.M është vendosur në kujdestari ligjore pranë Institutit “Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjëres Matara”, Rezidenca “Marie Tuci”. Ankuesi dhe nëna e B., znj. V.J rezulton se kanë qenë palë në këtë proces gjyqësor, të cilin e kanë lënë në mungesë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.06.2021, pasi nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse, përfshi ankuesin.

Vendosja e fëmijës në kujdestari nuk e shuan të drejtën e prindit apo fëmijës së ndarë nga prindi për t’u takuar dhe për të mbajtur marrëdhënie personale dhe vetjake me njëri tjetrin, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij. Në rastin konkret, nuk rezulton që të ketë një vendim gjykate që të ketë vendosur se është në kundërshtim me interesin më të lartë të fëmijës B.M që të takohet dhe të ketë marrëdhënie personale me babin e saj, ankuesin K.M.

Gjykata, në vendimin për caktimin e kujdestarisë së fëmijës B.M pranë Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara”, Rezidenca “Marie Tuci”, nuk ka bërë asnjë rregullim mbi mënyrën se si duhet të realizohen takimet midis fëmijës dhe prindërve apo të afërmit e tjerë. Ndërkohë ankuesi pranon se, që në momentin që vajza është vendosur në kujdestarinë e Institutit ajo ka mbajtur kontaktet me të afërmit nëpërmjetë komunikimit telefonik, takimeve, por dhe me ankuesin nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, deri në momentin që ai është liruar nga burgu. Pas daljes së ankuesit nga burgu, deri para ngjarjes së ndodhur në datën 10.07.2021, nuk konstatohet që ankuesi të ketë patur raste kur i është mohuar e drejta për t’u takuar me vajzën.

Pas kësaj ngjarje, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara” deklaroi se, për shkak të sjelljes së dhunshme nga ana e ankuesit, ata janë ndjerë të frikësuar dhe kërcënuar nga sjellja e z. M., por ata nuk i kanë mohuar atij të drejtën për t’u takuar dhe për të mbajtur kontakte me vajzën. Për shkak të situatës së krijuar, ata deklarojnë se edhe vajza ka refuzuar që të takohet dhe komunikojë me ankuesin. Nga ana e Institutit u paraqitën gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës akte të cilat sipas tyre janë shkruar nga B., në të cilat ajo shkruan se nuk dëshiron të takohet me të atin. Pretendimet e ankuesit se ndaj vajzës është ushtruar presion për të mbajtur një qëndrim refuzues ndaj tij nuk rezultuan të provuara.

Momenti i vetëm konkret i pretenduar nga ankuesi se nuk është lejuar që të takohet me vajzën e tij është data 22.5.2023, pas kthimit të tij nga Gjermania në datën 06.03.2023, sikurse vetëdeklarohet nga ankuesi.

Pas ngjarjes së datës 10.7.2021, ankuesit nuk rezultoi t’i jetë mohuar e drejta për tu takuar me vajzën e tij, por nga ana e strukturave të shërbimeve sociale të Bashkisë Lezhë, është vlerësuar dhe vendosur që takimet e ankuesit me vajzën të zhvillohen nën mbikqyrjen e punonjësve socialë.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga NJMF Bashkia Lezhë, të cilat nuk u kundërshtuan nga ankuesi, rezultoi se ankuesi ka patur takime me vajzën e tij B., ndonjëherë i shoqëruar dhe nga i vëllai, takime të qeta të cilat janë bërë dhe me dëshirën e vajzës për të kaluar kohë me të atin dhe këto takime janë realizuar në mbikqyrje nga punonjës socialë të Bashkisë Lezhë.

Sa më sipër, gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk rezultoi që, Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, me veprimet dhe mosveprimet e tij, të ketë cenuar të drejtën e ankuesit për të takuar dhe për të patur marrëdhënie personale dhe vetjake me vajzën e tij B.M.

Nuk rezultoi nga aktet e administruara se ankuesi të ketë patur kundërshtime në lidhje me vendosjen në kujdestari të vajzës së tij pranë Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca MarieTuci, për shkak se është një institucion me natyrë fetare dhe fëmija mund të ndikohej nga feja. Kundërshtimet në lidhje me këtë fakt ankuesi i ka paraqitur për herë të parë në ankesën e paraqitur para Komisionerit.

Komisioneri çmon të ndalet në këtë moment, duke theksuar se, pavarësisht se Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, është një ent kishtar që ushtron kryesisht aktivitet fetar, shërbimet e përkujdesit shoqëror të ofruara për fëmijët nga ky subjekt në Rezidencën Marie Tuci, për të cilën ai është i pajisur me licencën përkatëse, janë shërbime publike. Në këtë kuptim, në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për fëmijët në Rezidencën “Marie Tuci”, Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara nuk janë duke ushtruar aktivitet fetar por janë duke ofruar një shërbim publik. Pavarësisht natyrës fetare të subjektit, për shkak se shërbimi objekt shqyrtimi është një shërbim publik, ai duhet të ofrohet në mënyrë laike dhe i pa ndikuar nga natyra dhe karakteri fetar i vetë subjektit.

Gjithahstu, Komisioneri thekson se, duhet të respektohet e drejta e prindërve që edukimi dhe arsimimi i fëmijëve të bëhet në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi K.M nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me pretendimet e parashtruara në ankesë, nga ana e Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci”. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Nisur nga gjetjet e bëra gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstaton me shqetësim se, nga ana e Bashkisë Lezhë, por edhe Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca Marie Tuci, nuk është kryer asnjë vlerësim psiko-social i gjendjes dhe nevojave të fëmijës B.M, si pasojë e situatës së krijuar. Ky konstatim bëhet akoma më shqetësues, kur nga aktet e vendosura në dispozicion rezulton se, në ditarin e saj B. shkruan se: “ *Unë dua të vdes para se babi im të më marr*”.

Institutit Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca Marie Tuci, deklaroi se Bvazhdon të ketë rezultate të mira në shkollë, por vitin e fundit kanë marrë ankesa nga mësuesit për sjellje jo të mira në klasë nga ana e saj dhe po shqyrtojnë nevojën për t’u konsultuar me një psikiatër fëmijësh, i cili mund ta ndihmojë atë për të kontrolluar veten.

Komisioneri konstaton se, në kundërshtim me vendimin e gjykatës, Shërbimi Social i Bashkisë Lezhë, nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në këtë vendim, për të kontrolluar progresin edukativ dhe arsimin të fëmijës, duke përgatitur raporte përkatëse, një herë në muaj, ditën e hënë të javës së tretë.

Sa më sipër, Komisioneri, bazuar në misionin e tij si një institucion që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, si kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “f”, të LMD, ku parashikohet se, Komisioneri ka kompetencë të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin, rekomandon Institutin Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci” dhe Bashkinë Lezhë, që të marrin masa për të vlerësuar gjendjen dhe nevojat psiko-sociale të

fëmijës B.M dhe të ndjekin në mënyrë sistematike gjendjen e fëmijës deri në normalizimin e saj, bazuar në raporte psiko-sociale të kryera nga ekspertë të licencuar për vlerësimin e fëmijëve. Bashkia Lezhë duhet të marrë masa që në zbatim të vendimit nr.04, datë 22.01.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, të kontrollojë progresin e edukimit dhe arsimit të fëmijës B.M, duke përgatitur raportet përkatëse, sipas përcaktimeve përkatëse në vendimin e gjykatës, një herë në muaj ditën e hënë të javës së tretë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 21, 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit K.M, nga ana e Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci”, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Rekomandohet Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci” dhe Bashkia Lezhë, për të marrë masa të menjëhershme për të vlerësuar gjendjen dhe nevojat psiko-sociale të fëmijës B.M.
3. Rekomandohet Bashkia Lezhë, për të marrë për të kontrolluar progresin e edukimit dhe arsimit të fëmijës B.M nëpërmjet përgatitjes së raporteve përkatëse, një herë në muaj ditën e hënë javës së tretë, në zbatim të vendimit nr.04, datë 22.01.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.
4. Instituti Shërbëtorët e Hyut dhe të Virgjërës Matara, Rezidenca “Marie Tuci” dhe Bashkia Lezhë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shaku: Raca, ngjyra, statusi si i dënuar  
Fusha: Të mira dhe shërbime  
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim

